



Njihu Me Panian

Ndjekja e Jezusit në Tajlandë

Si e Ndjek Pania Jezusin

Pania e fton kushëririn e saj të shkojë me të në Kishë. Kur ai vjen, Pania e ndihmon atë të ndihet i mirëpritur. Ajo e ndihmon atë të njihet me fëmijët e tjerë në Fillore dhe të zërë miq.

Në shtëpi, Pania ndihmon duke pastruar kutinë e saj të ushqimit dhe këpucët e saj. "Unë zbavitem kur ndihmoj", – thotë Pania. Ajo jeton me hallën e saj dhe gjyshen e saj dhe i pëlqen shumë t'i ndihmojë ato. Ajo gjithashtu e palos çdo mëngjes batanijen e saj.

Mami i Panias ndërroi jetë jo shumë kohë më parë. Kur Panian e merr malli për mamin e saj, halla e saj e ndihmon që t'i lutet Atit Qiellor. Ajo, pasi lutet, ndien se e duan. "Kur lutem, ndiej sikur Jezusi është me mua", – thotë ajo.



Pania me gjyshen dhe hallën e saj.

Edhe Ti Mund ta Ndjekësh Jezusin!

Çfarë është diçka që e ke bërë për ta ndjekur Jezusin? Na shkruaj dhe na trego! Drejtoju kapakut të pasmë për të parë se si ta bësh atë.



สวัสดี!



Rreth Panias

MOSHA: 7 vjeçe

NGA: Nontaburi, Tajlandë

GJUHA: Tajlandisht

SYNIMI: Të bëhet projektuese mjedisesesh të brendshme dhe të zbukurojë dhomat në shtëpi e ndërtesa

HOBITË: Të kërcejë, të ngasë biçikletën e saj, të mësojë pianon, të notojë, të lexojë dhe të bëjë tajkuondo

FAMILJA: Pania, halla dhe gjyshja

Gjërat e Parapëlqyera të Panias

HISTORIA E JEZUSIT: Kur Ai u pagëzua (shih te Mateu 3:13–17)

DITA E FESTËS OSE TRADITA FAMILJARE: Krishtlindja dhe udhëtimet familjare

FRUTA DHE PERIME: Rrushi jeshil dhe kastravecët

NGJYRA: Vjollcë

KËNGA E FILLORES: "Tempullin Shum' Dua t'Shoh" (Libri i Këngëve të Fëmijëve, f. 99)